



RELACION TEKNIK+SPECIFIKIME

Mbi

Rishikim Projekti Restaurimi

Punoi: Ark. Arbjona BALA

Ark. Fotjon Qirinxhi

Ing.Xhuljana Avdolli

MIRATOHET

PËR K.K.T.K.M.

SEKRETARI

Klesta
Qirici

Digitally signed by Klesta
Klesta QIRICI
Date: 2023.07.14 13:04:23
+02'00'

TIRANË QERSHOR 2023



PËRMBAJTJA:

VENDNDODHJA.....	3
ANALIZA HISTORIKO–ARKITEKTONIKE.....	4
Të Dhënat Historike.....	4
Analiza Arkitektonike.....	4
FAZATE NDËRTIMIT TË KISHËS.....	6
KONSERVIMI DHE NDËRHYRJET RESTAURUESE NË VITE.....	8
GJENDJA E KONSERVIMIT.....	9
NDËRHYRJET RESTAURUESE TË PARASHIKUARA.....	14
SPECIFIKIME TEKNIKE.....	19
PREVENTIV	
MATERIALI GRAFIK	

Shënim:

Projekti dhe relacioni janë përgatitur bazuar dhe në projektin dhe relacionin e vitit 2015 ku pjesë e grupit të projektimit janë:

Ark.Albjona Bala

Urb.Kostika Bardhyli

Ark.Elvira Tuxhari

Ing.Endrita Mulleti

VENDNDODHJA

Kisha e Shën Mërisë ndodhet në fshatin Barmash, të rrethit të Ersekës. Kisha mund të arrihet lehtësisht me rrugë automobilistike. Kisha është pjesë e kompleksit të varrëzave të fshatit dhe ky territor është i rrethuar me kangjella.




ANALIZA HISTORIKO - ARKITEKTONIKE

Të Dhënat Historike

Sipas studimit kisha e Shën Mërisë është piktuaruar më 1606. Datë të saktë të ndërtimit të kishës nuk ka por kjo kishë i përket shekullit të XVII.

Analiza Arkitektonike

Kisha e Shën Mërisë në Barmash është kishë e tipit sallë me kupolë. Kisha përbëhet nga naosi, ambienti i altarit, narteksi dhe hajati i ndërtuar në një fazë më të vonë në anën jugore. Sipërfaqja e përgjithshme e kishës është 21x9,1 m. Kisha në përbërjen e saj ka patur të ngritura 5 kupola, nga të cilat vetëm dy prej tyre janë ekzistuese.



Naosi, tek i cili hyhet nga ana jugore, përbëhet nga dy bërthama katrore dhe një drejtëkëndëshe. Bërthamat anësore mbulohen me kësula sferike direkt mbi harqet mbajtës, sepse pilastrat në mure formojnë pjesë katrore. Bërthama qendrore pranë harqeve mbajtëse ka në anët veriore dhe jugore nga një hark të dytë që zvogëlon hapësirën dhe krijon katrorin mbi të cilin ngrihet kësula sferike (kupola). Naosi ndriçohet nga dy dritare në murin jugor dhe ka qenë e ndriçuar dhe nga një baxhë që hapej në çati e cila tani nuk ekziston më, dhe nga një dritare në anën veriore në pjesën e altarit, sipër nikes e hapur më vonë.

Ambienti i altarit relativisht i ngushtë mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje-

perëndim dhe përbëhet nga bema që shkon deri në tokë në brendësi dhe del në faqen lindore me absidë trefaqëshe dhe protezisin e diakonikonin më të vogla se bema si dhe dy nike të tjera në muret veriorë dhe jugorë.

Narteksi përbëhet prej dy bërthamash të formuara si më lart me pilastra dhe harqe mbajtës e të mbuluara me kësulë sferike. Narteksi ndahet nga naosi me një mbushje të harkut mbajtës që i ndante, duke patur për lidhje një portë të ulët. Ai ndriçohet nga tre dritare të vogla në murin perëndimor.

Hajati i shtuar më vonë ka qenë i hapur në anën jugore dhe i vendosur mbi shtylla druri.

Muratura e kishës është e çrregullt me gurë dhe llaç gëlqereje, ndërsa muratura e hajatit me gurë e llaç balte.

Dyshemeja në pjesën e naosit përbëhet nga pllaka guri në forma dhe përmasa të Çrregullta dhe nga tokë natyrale. Pllakat e gurit janë të vendosura në tokë natyrale pa element lidhës. Poshtë kupolës së parë, në afërsi të altarit kemi një pllakë guri formë rrethore (rozetë). Altari ngrihet me dy shkallë nga naosi. Dyshemeja e altarit është shtruar me pllaka guri të skuadruar të vendosura në mënyrë të rregullt. Në ambjentin e hajatit nuk kemi gjurmë të shtrimit me gurë por vetëm tokë natyrale.

Ndriçimi i ambjentit të naosit realizohet nëpërmjet dy dritarësh të cilat ndodhen në fasadën jugore dhe një dritareje të vogël të hapur më vonë në fasadën veriore. Dritaret jugore kanë përmasa 60 x 72 cm, ndërkohë që dritarja e vogël ka përmasa 40 x 45 cm. Dritaret përbëhen nga kasë druri të inkastruar në muraturën e gurit, nuk kanë xham por janë të pajisura me kangjella metalike. Ambjenti i narteksit ka qenë i ndriçuar nga tre dritare në formë frëngjish në fasadën perëndimore.

Çatia e kishës është çati me rrasa guri. Çatia ekzistuese mbulon vetëm një pjesë të naosit dhe portën hyrëse në hajat. Çatia është e mbështetur mbi kupola çka ka sjellë dhe dëmtime të shumta të kupolave.

Ambienti i altarit relativisht i ngushtë mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje-perëndim dhe përbëhet nga bema që shkon deri në tokë në brendësi dhe del në faqen lindore

me absidë trefaqëshe dhe protezisin e diakonikonin më të vogla se bema si dhe dy nike të tjera në muret veriorë dhe jugorë.

Narteksi përbëhet prej dy bërthamash të formuara si më lart me pilastra dhe harqe mbajtës e të mbuluara me kësulë sferike. Narteksi ndahet nga naosi me një mbushje të harkut mbajtës që i ndante, duke patur për lidhje një portë të ulët. Ai ndriçohet nga tre dritare të vogla në murin perëndimor.



Teknika e ndërtimit.


Kisha është e ndërtuar me gurë të paskuadruar të vendosur në rreshta me tendencë horizontaliteti. Muratura e kishës është e çrregullt me gurë gëlqerorë të lidhur më llaç gëlqereje, ndërkohë që muratura e hajatit është gur e llaç balte. Muratura është e përbërë nga dy paretet e jashtme dhe me mbushje në mes. Nuk dallohet prezenca e brezave të drurit nga jashtë përveçse në muret e brendshme të ambjentit të shërbimit. Gjatë viteve kisha ka pësuar ndërhyrje të shumta nga banorët, disa prej të cilave nuk janë bërë sipas kushteve teknike. Vihen re pjesë të restauruara me gurë smërçi të marra nga kupolat e rëna. Muratura e portës hyrëse kryesore për në hajat dhe naos është restauruar me llaç çimentoje. Për ndërtimin e apsidës janë përdorur gurë gëlqeror të paskuadruar të lidhur me llaç gëlqerej dhe katër rreshtat e fundit janë të ndërtuar me gurë smërçi.

KONSERVIMI DHE NDERHYRJET RESTAURUESE NE VITE

Duke u mbështetur në materialet e gjetura në arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës, del në pah se Kisha e Shën Mërisë në Barmash i është nënshtruar disa ndërhyrjeve restauruese.

1966 – Materiali grafik më i hershëm i dokumentuar në arkivën e IMK-së janë rilevime të vitit 1966. Nga vizatimet vihet re se kisha ka pësuar ndërhyrje të mëparshme pasi pjesa e hajatit i cili mendohet ka qenë një ambjent i hapur dhe i mbështetur në kollona druri, në këto rilevime paraqitet i mbyllur dhe një pjesë e Çatisë në anën lindore të hajatit paraqitet e rrëzuar.






1977 –Në raportin e këtij viti, gjendja e kishës paraqitet e mirë, por vetëm kërkon që territori të pastrohet rreth e përqark.



1985– Në këtë vit është realizuar një projekt restaurimi nga specialistët e IMK-së, ku ndër zërat më kryesorë janë: revizionimi i çatisë me një kullim të hajatit nga ana jugore; çatia me konstrukcion druri mbi qemer guri; hapja e kanaleve nga lindja e jugu dhe mbrotja e e terrenit nga ana lindore; pastrim ambjenti nga bimësia e dëmshme.



1987 – Edhe gjatë kësaj periudhe nuk shfaqet asnjë problem strukturor por vetëm sistemim skarpatah anësore të gërmuara në anën e mureve mbajtëse të thatë si dhe pastrimi i ambjentit rreth kishës.

GJENDJA E KONSERVIMIT (Viti 2015)

Gjendja ekzistuese e Kishës paraqitet mjaft e degraduar, një pjesë e kishës është e rrënuar plotësisht.

Një pjesë e naosit dhe gjithë ambjenti i narteksit është i degraduar. Muret e brendshëm bashkë me kupolat dhe çatinë janë rrëzuar. Në këmbë kanë mbetur një pjesë e mureve perimetralë të kësaj pjese të rrëzuar, por dhe këto mure janë në gjëndje kritike shembjeje.



Pamje nga Kisha e Shën Mërisë, Barmash

Kisha ka pesë ambiente me kupola, prej të cilave vetëm dy ambientet e naosit që të shpien për tek altari dhe apsida e kishës janë ekzistuese.

Hajati është totalisht i shkatërruar, ekzistuese qëndron vetëm porta hyrëse bashkë me çatinë.

Në vend u evidentuan dhe problematika të tjera të lidhura me strukturën e kishës:

- Muratura e kishës është ndërtuar me gurë gëlqerorë por në vend u vunë re disa fragmente të restauruar me gurë smërçi të marra nga kupolat, pas rrëzimit të tyre.



Fragmente murature të restauruar me gurë smërçi të marrë nga kupolat

- Gjatë ndërhyrjeve restauruese, fugat e portës hyrëse për në hajat janë fugatuar me llaç çimetoje.



- Degradimi i llaçit të fugave



Degradimi i llaçit gëlqeror të fugave

- Në ambjentet e brendshme të kishës, përgjatë mureve perimetralë vërehen shenja lagështie dhe myku në lartësinë 50 – 100 cm duke sjellë shkëputjen e suvasë dhe degradimin e materialit gurorë.



Shenja të lagështisë në muret e brendshëm perimetralë

- Materiali drusor i tiranteve i degraduar dhe ka humbur funksionin mbajtës




Materiali drusor i tirantave i degraduar

- Pjesa ekzistuese e naosit dhe altarit paraqitet mjaft problematike: çarje të shumta në pjesën e kupolave, të dritareve dhe në pjesën e qemerëve.



Çarje të shumta vertikale dhe gjatësore

- Piktura murale që vesh pjesën e naosit u inspektua nga specialistët e artit. Kjo pikturë paraqet të djegura dhe degradime nga lagështia si pasojë e dëmtimit të çatisë.



Degradimi i pikturës murale

- Një faktor tjetër i degradimit të mëtejshëm është prezenca e bimësisë së lartë dhe të ulët. Bimësia e lartë vazhdon të rritet në ambjentet e brendshme të kishës.



Prezencë vegjetacioni

GJENDJA EKZISTUESE QERSHOR VITI 2023

Të përgjithshme

- Rënie catise se kishes ne pjesen e Narteksit se bashku me muret deri ne gjysmen e lartesisë se tyre (evidentim i vitit 2015);
- Rënie e catisë në një pjesë të naosit (evidentim i vitit 2015);
- Rënie catisë e të gjithë pjesës së hajatit dhe mureve anësore të tij (evidentim i vitit 2015);
- Rënie muraturës në pjesën e hyrjes në kishë.

- Prezenca bimese e larte e mbire ne brendesi te kishes ne pjesen e narteksit, hajatit , dhe përreth kishës ;
 - Carje te thella ne muraturen e kishes të Naosit
 - Carje ne kupola dhe qemere në pjesën e Naosit;
 - Degradim I catise ekzistuese me rrasa guri;
 - Demditi i shtreses se dyshemese me pllaka guri;
 - Degradim I elementeve drusore dyer/dritare, karrige druri;
 - Degradim I tiranteve te drurit;
 - Demtim I llacit lidhes ne murature si pasoje e agjenteve atmosferike në fasadë;
 - Ndërhyrje të gabuara qe janë evdientuar dhe më përpara në vitin 2015.
-
- Shkakut kryesor i shembjes së narteksit mendohet të jenë lëvizjet sizmike që kanë ndodhur si dhe uljet (cedime) që kanë pësuar muratura e themeleve e cila evidentohet dhe në pjesën e carjeve në kupola dhe qemere në pjesën e naosit të cilat janë ekzistuese . Sic duket dhe nga fotot më poshtë harku i qemerit në pjesën e naosit ka pësuar carje shumë të mëdha si dhe zhvendosje nga pozicioni fillestar në pjesën e celësit të harkut duke rrezikuar dhe më shumë këtë kishë . Shkakut kryesor i lëvizjes dhe carjeve ne qemer mendohet të jenë cedimet që kanë ndodhur në muraturën e themeleve të ndikuara dhe nga lëvizjet sizmike duke marre parasysh dhe vendodhjen e kishës.
 - Gjithashtu carjet dhe degradimi i mëtejshëm i tyre ka ardhur dhe për arsye të mosfunksionimit të tirantave të drurit në pjesën e fundit të harkut për eliminimin e forcave horizontale .



Foto të carjeve në kupola dhe qemere qershor 2023



Foto të tirantave të degraduar dhe të mbuluar me dërrasa të cilat e kanë izoluar ajrosjen dhe kanë sjellë kalbjen e drurit të brendësi duke humbur funksionin e tyre.


Prezenca e bimësisë e evidentuar dhe më përpara në vitin 2015 e cila është rritur akoma më shumë dhe është shtuar duke ndikuar dhe në pjesën e muraturës.





Prezence bimesie foto qershor 2023

- Çatia gjithashtu paraqitet në gjëndje të degraduar, përse i përket pjesës prezente dhe vërejmë se baxha e altarit paraqitet e mbyllur, ndryshe nga sa ka qenë në originalitet.



Majtas paraqitet gjendja ekzistuese e çatisë; djathtas paraqitet foto e vjetër ku dallohet detaji i baxhës, sot i humbur.



Foto të catisë qershor 2023

Nga inspektimi i fundit gjendja e catisë është jo e mirë , duken një pjesë e plllocave të vendosura në gjendje jo të rregullt të grumbulluara , pjesa e brendshme nuk mund të kontrollohej për arsye se catia është e mbështetur mbi kupola dhe pjesa e baxhos është dëmtuar dhe hequr . Gjatë punimeve të restaurimit duhet të bëhen sondazhe dhe evidentimi i gjëndjes së catisë dhe strukturës së saj të brendshme .



- Rënie muraturës në pjesën e hyrjes në kishë. Pjesa e muraturës e evdientuar në vitin 2015 nuk ka qënë e rrëzuar kurse në ditët e sotëme ajo paraqitet e rrëzuar duke sjellë rrezikimin e pjesës së mbetur të hajatit dhe murit të naosit.
- Foto të muraturës së rrëzuar:
-





- Shtresa e dyshemesë është shumë e degraduar dhe jo e rregullt sic duket dhe në foto, gjithashtu muratura ka prezencë lagështie në pjesën fundore të muraturës e cila ka cuar në dëmtimin e mëtejshëm të pikturës prezente në këto pjesë :





- Në fotot më poshtë tregohet dhe gjëndja e elementeve drusore dyer/dritare, karrige druri të cilat kanë pësuar degradime të mëtejshme krahasur me vitin 2015.






NDERHYRJET RESTAURUESE TE PARASHIKUARA

Të përgjithshme


- Restaurim i catise ekzistuese me rrasa guri e cila mbështetet sipas skemes origjinale mbi sistemin e kupolave . (riberja e baxhos ne naos)
- Ringritje e catise ne ambjentin e Narteksit te mbështetur mbi konstruksion druri dhe ringritjen e catisë dhe lidhjen me catinë ekzistuese në pjesën e Naosit pas ringritjes së kupolës në pjesën e naosit.
- Ringritje e kupolës së tretë në pjesën e naosit dhe qemereve anësore për nga pjesa e narteksit.
- Ringritje e muraturës së narteksit duke kryer fillimisht restaurimin e asaj ekzistuese dh e më pas ngritje e muraturës bazuar në tekninën e ndërtimit të muraturës ekzistuese deri në nivelin e muraturës së naosit për vazhdimin me ringritjen e catisë në këtë pjesë për mbylljen e objketit.
- Ringritje dhe restaurim i muraturës së hajatit në të gjithë gjatësinë e hajatit duke evidentuar muraturën sipas gjurmeve ekzistuese ne vend dhe rilevimeve dhe fotove te vjetra te Arkivit te IKTK-se;
- Pastrim nga bimesia e larte dhe e ulët e mbire ne brendesi te kishes dhe perreth saj;
- Qepje te carjeve vertikale ne murature në pjesën e jashtëme dhe ku nuk ka prezencë pikturë me injektim duke bërë dhe fugatimin e te gjithë muratures dhe injektimin ne teresi te saj;
- Qepje te carjeve ne kupola e qemere me injektim:

Fillimisht do të behet puntelimi nga poshte I kupolave dhe qemereve më pas do vazhdohet me : cmontimi I catise, pastrimi I kupolave nga mbushjet dhe dherat, injektimi I carjeve në varësi të madhësisë të tyre dhe qepje me ganxha metalike në qoftë se do ketë nevojë, shtrese llaci horasan siper kupolave per hidroizolim, duke I dhene pjerresine e catise, vendosja e elementeve drusore dhe petavrave, shtrese katrama, rrasa guri;


- Restaurim I dyshemese me rrasa guri;
- Restaurimi përfshin të gjithë shresën ekzistuese të naosit duek ruajtur sa më shume originalitetin e saj , , sondazhin dhe resturimin e shtresës së narteksit dhe më pas restaurim e shtresës së hajatit.
- F.V. dyer, dritare sipas modeleve origjinale ;
- F.V. Tirante druri duke kryer zëvëndësimin e atyre ekzistuese me kujdes duke krijar lidhej e tyre me muraturën ;




PRERJE A-A' E KISHES/ EKZISTUESE




PRERJE A1-A1' E KISHES/ EKZISTUESE



PRERJE B-B E KISHES/ EKZISTUESE



PRERJE B1-B1 E KISHES/ EKZISTUESE



PAMJA VERIORE E KISHES/ EKZISTUESE

Renie/degradim e catise me rrasa guri

Çmontim, zbritje, sistemim, seleksionim, rrasa guri me pastrim; Pastrim i qemereve dhe kupolave nga mbushja dhe llaçi i degraduar; Injektivim i çarjeve në kupolë dhe qemere; Shtrese llaçi horasan mbi kupolë; Çati HD-10m mbuluar me rrasa guri;

Mungese e fugatimit të murit

Fugatim muri llaç gëlqere (pastrim mekanik+larje me ujë+fugatim)

Çarje në murature

Restaurim i çarjeve në mur guri me tekniken e injektivimit (Pastrim i çarjes, larje me ujë, injektivim llaç gëlqere 1:3)

Kupola në dukje


Prezence bimesi e lartë në brendësi të ambientit të narteksit
Prerje dhe tharje të rrenjeve masive(raundap 200cc)

Dëmtim i muratures së gurit

Restaurim muri guri me llaç gëlqere 1:3 me tekniken shqep-qep (pjesa e narteksit)

Muratura perimetrale e narteksit, rënuar

Restaurim muri guri me tekniken shqep-qep i muratures ekzistuese e cila është e degraduar, ndërtim muri në lartësi të pjesës që mungon



PAMJA JUGORE E KISHES/ EKZISTUESE

Renie/degradim e catise me rrasa guri

Çmontim, zbritje, sistemim, seleksionim, rrasa guri me pastrim; Pastrim i qemereve dhe kupolave nga mbushja dhe llaçi i degraduar; Injektivim i çarjeve në kupolë dhe qemere; Shtrese llaçi horasan mbi kupolë; Çati HD-10m mbuluar me rrasa guri;

Fugatim muri me cimento, ndërtim dhe gabuar

Fugatim muri llaç gëlqere (pastrim mekanik+larje me ujë+fugatim)

Prezence bimesi e lartë në brendësi të ambientit të narteksit

Prerje dhe tharje të rrenjeve masive(raundap 200cc)

Murature e narteksit e rene

Restaurim muri guri me tekniken shqep-qep i muratures ekzistuese e cila është e degraduar, ndërtim muri në lartësi të pjesës që mungon


Degradim i dritareve të drurit

F.V. dritare druri

Restaurim dritare druri

Çarje në muraturen e gurit

Restaurim i çarjeve në mur guri me tekniken e injektivimit (Pastrim i çarjes, larje me ujë, injektivim llaç gëlqere 1:3)




Mur i dëmtuar


Ndërtim muri guri i hajatit

Dihet të grumbullohet në kohë
Hogje dhe transport me kamion dhe (sistemim territori përreth)


PAMJA LINDORE E KISHES/ EKZISTUESE



PRERJA GJATESORE/ PROPOZIMI




PLANI I MBULIMIT/ PROPOZIMI




- | | |
|---|-------------------------------|
| Gjendja ekzistuese | Pjesa e mbulimit (Restaurim) |
| Volume qe plotesohen | Pjesa e mbulimit (Propozim) |
| Kupola (Kalota perendimore) qe plotesohet | Ndertim mur guri ne hajat |
| | Shtrese me pllaka guri |


PREJRA TERHORE/ PROPOZIMI



PAMJA LINDORE/ PROPOZIMI



Pamja jugore pas restaurimit



SPECIFIKIME TEKNIKE

Specifikime të përgjithshme

1.1.1 *Njësitë matëse:*

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, Km, N (Njuton), Ton (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “.”.

1.1.2 *Qëllimi i punës:*

Kontraktori duhet të bëjë kujdes në zbatimin e punimeve sipas projektit të miratuar në KKR në përputhje dhe me kushtet e kontratës si dhe të plotësojë çdo difekt gjatë punimeve. Kontraktuesi do të sigurojë që drejtuesi teknik i punimeve restauruese të jetë prezent gjatë gjithë procesit të zbatimit të punimeve, gjithashtu personeli i kualifikuar për këto tipologji punimesh. Kontraktuesi do të sigurojë materialet, pajisjet dhe të gjitha sendet e tjera, qoftë të një natyre të përkohshme ose të përhershme, të nevojshme për zbatimin dhe përfundimin e punëve, dhe për korrigjimin e ndonjë defekti, për aq sa është e specifikuar në këtë dokument, ose mund të nxirret në mënyrë të arsyeshme gjatë zbatimit të kontratës nga Drejtuesi i Projektit më tej i quajtur Mbikqyrësi i Punimeve.

1.1.3 *Grafiku i punimeve:*

Kontraktuesi duhet t’i japë Mbikqyrësit të Punimeve një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në restaurim deri në mbarim të punës.

1.1.4 *Informacioni që duhet të sigurohet mbikqyrësit të punimeve duhet të përfshijë:*

- Vizatime grafike që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të ansamblit dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim;
- detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme;
- plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për ndërtim e restaurim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim,
- detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga Mbikqyrësi i Punimeve të restaurimit, dhe *çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga mbikqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të punimeve.*

1.1.5 Punime të gabuara:

Çdo punë, që nuk është në përputhje me projektin e aprovuar nga KKR, dhe këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit. Në rastet kur kontraktori i punimeve restauruese gjykon të adaptojë punime gjatë procesit të restaurimit në funksion të këtij procesi, *çdo ndryshim bëhet me aprovim të Mbikqyrësit të Punimeve dhe këto adaptime nuk duhet të prekin thelbin e projektit.*

1.1.6 Punime të rrezikshme:

Magazinimi ibombolavetë gazit me presion në ambientet e brendshme të monumentit është e ndaluar. Gjatë punimeve të rrezikshme megazrat ende zshmeduhen mbajtur fikëse zjarri sipas DIN EN3 duhet të jetë në dispozicion pranë mevendin ku punohet.

1.1.7 Tabelat njoftuese, etj:

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç: Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Mbikqyrësi i punimeve dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 100 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.

1.1.8 Sigurimi Teknik:

Kontraktori do të zbatojë të gjitha punimet sipas standarteve Europiane dhe Shqiptare të sigurimit teknik në punë. Ai duhet të sigurojë një plan për sigurimin teknik dhe staf të kualifikuar për inspektimin e sigurimit teknik, kryerjen e instruktimit teknik për çdo punonjës dhe për çdo zë pune specifik. Gjatë punimeve të prishjes punëtorët duhet të veshin rroba të duhura të sigurisë duke përfshirë syze nëmbrojtjen e syrit, maska pluhuri, këpucë të sigurisë, dorezatë punës dhe kasketa të forta. Mbajtjen e procesverbaleve për çdo lloj aksidenti në punë dhe mbarëvajtjen e sigurimit teknik të cilin duhet tja prezantojë Mbikqyrësit çdo muaj.

1.2 Dorëzimet te Mbikqyrësi i Punimeve:

1.2.1 Autorizimet me shkrim:

“Rregullat me shkrim” do t’i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Mbikqyrësi i Punimeve të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë zbatimin e kësaj kontrate. Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuar, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuar, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje), aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat instruksionet, emërimet, urdhëresat e Mbikqyrësit të punimeve do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

1.2.2 Dorëzimet tek Mbikqyrësi i punimeve:

Kontraktori duhet t’i dorëzojë Mbikqyrësit: *për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Mbikqyrësi.* Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çertifikata testi, kurdo që të kërkojnë nga Mbikqyrësi. Mbikqyrësi i Punimeve do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t’i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Mbikqyrësin e Punimeve dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Mbikqyrësit për të bërë këto pranime.

1.2.3 Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet siç është zbatuar)

Kontraktori duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet “siç janë zbatuar faktikisht” në terren. Gjatë zbatimit të punimeve në kantier, Kontraktori do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e “Vizatimeve siç është zbatuar”. Do të shënojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentat e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar. Këto vizatime do të azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do t’i dorëzohen Mbikqyrësit të punimeve çdo muaj për aprovim, pasi punimet të kenë përfunduar, së bashku me kopjen përfundimtare. Materiali mujor do të dorëzohet në kopje letër.

Vizatimet e riprodhuara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksioneve mbajtëse të lëna gjatë gjurmimeve dhe vendosjen ekzakte të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit. Kontraktori gjithashtu duhet të përgatisë seksionet e profilit gjatësor të rishikuar, pajisur me shënime që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjitha punimeve të gjurmimit.

Si përfundim, kopjet e riprodhuara të Vizatimeve, “siç është zbatuar” do t’i dorëzohen Mbikqyrësit për aprovim.

1.2.4 Mostrat:

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkojnë me të drejtë nga Mbikqyrësi për inspektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Mbikqyrësit.

1.2.5 Zëvendësimet

Zëvendësimi i materialeve të specifikuara do të bëhet vetëm me aprovimin e Mbikëqyrësit të Punimeve i cili duhet të jetë i argumentuar dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë apo origjinalitetit të veprës. Nëse materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Kontraktorit, që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë.

1.2.6 Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe librezat e masave:

Kontraktori do t’i përgatisë dhe dorëzojë Mbikqyrësit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shpesh të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Mbikqyrësi, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

1.2.7 Dokumentat dhe vizatimet:

Kontraktori do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasinë dhe detajet të treguara në Vizatimet, Grafikët, ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë Kontraktorin nga përgjegjësia për punë të pakënaqëshme. Kontraktori do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i plotë do të jepet nga Punëdhënësi nëse gabime të tilla ose mospërputhje do të zbulohen.

1.2.8 Fotografitë e sheshit të ndërtimit;

Kontraktori duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve.

1.3 Objekte ekzistuese

1.3.1 *Shërbimete brendshme:* Prioritet është që para fillimit të prishjeveshërbimet komunalenëzonën eprishjevedo të nxirren jashtë funksionidhe të sigurohen që rifutja në punë e paqëllimshme të ndalohe.

1.3.2 Gjatëprishjes sëelementëve të suvatuar të tilla simure, xokol, suvajaduhet prerëpastërnëkufijtë eseksionittë prishur.

1.3.3 *Betonetdhepllakat:*Prerja me sharrë e betonitduke hapur dhepllakatnë një thellësi prej5centimetranëngjendjenekzistuesepranë. Prerjet të jenë të drejta dhe në kufijtë e shtresës që do hiqet. Matrapikëtdotë përdorenvetëm në pjesën eprerëdhenukdotë përdorennë vend të sharrës.

1.4 Gërmimet:

Të mbushen të gjithë pjesët e gërmuara, kanale, gropa dhe pjesë të rrezikshme të hapura në tokë.Të tregohet kujdes gjatë gërmimeve pjesore, ato duhet të kryhen me krahë.

1.5 Hedhja dhe emërtimi i materialeve.

1.5.1 *Hedhjae materialeveekzistuese dhe pajisjeve:*

Duke përjashtuar rastet kutregohetnë specifikime,në raste të tjeratë gjitha materialetdhe pajisjet largohen dhenukripërdoren. Do të bëhenpronë Kontraktuesitdhedo të largohet ngakantieri.Titullimipër tëgjitha materialetqë rezultojnë ngaprishja, dhepajisjeve që do tëhiqen, i vishet Kontraktuesime miratimin eMbikqyrësit.Me autorizimnga Mbikqyrësi mund të fillojnëpunimetpër prishjen.Klienti nukdotë jetëpërgjegjës për gjendjen, humbjen osedëmtimit tëpronës pasnjoftimittë fillimit të prishjeve. Materialet dhepajisjet nukdotë shiten ngablerësit e mundshëmapo të shiten në kantier.

1.6 Zhurma & kontrolli i vibrimeve:

Nërastet kurprishjetdotë zhvillohennë ndërtesaendenë funksion; zhurmadhedridhjet epunës intensivenukdo të lejohenbrenda orarit të aktivitetit të objektit të kultitnë mënyrëqëshqetësimipërgjatë punëstë mbahet në minimum. Koordinimiipunëve të tillado të bëhetmeMbikqyrësin.

1.7 Kontrolli i pluhurave:

Të merren masat e duhura për të kontrolluar përhapjen e pluhurit dhe për të shmangur krijimin e një zonë të papërshtatshme përreth. Të jetë në përputhje me të gjitha rregulloret e pluhurit të vendosura nga kantieri dhe agjensitë lokale të ndotjes së ajrit. Gjatë prishjes së ndërtesave të cilat janë ende në përdorim duhet të vendosen perde pluhurit për të mbrojtur ato zona ende nën funksion të qarkullimit të pluhurit me ajrin. Kur elementet që prishen përmbajnë materiale fibra

atëherë duhet patur kujdes për të shmangur përhapjen e fibrave dhe në këtë mënyrë ndotjen. Njomja e materialit të tillë dhe përdorimi i maskave të pluhurit do të konsiderohet një masë minimale të mbrojtjes. Shpimit në materiale fibroze është i ndaluar.

1.8 Mbrojtja:

1.8.1 Puna ekzistuese:

Para fillimit të punëve Kontraktuesi së bashku me Mbikqyrësin duhet të inspektojë dhe të identifikojë të gjitha njësitet ekzistuese të cilat do të mbahen ose të ripërdoren. Një punë e tillë ekzistuese e cila është: (a) të mbeten në vend, (b), për ripërdorim, ose (c) të mbetet pronë e Klientit, do të mbrohet duke përdorur mbulesa të përkohshme, përforcuese dhe parandaluese. Objektet të cilat do mbeten dhe të cilat janë të dëmtuara gjatë kryerjes së punës do të riparohen në gjendjen e tyre origjinale ose të zëvendësohen me të reja me shpenzimet e Kontraktuesit. Nuk duhet të mbingarkohen elementet strukturore. Duhet të sigurohet mbështetje të reja dhe përfundime për ndërtimet dobësuar ekzistuese nga punimet e prishjeve. ***Në asnjë moment për çfarëdo lloji arsye nuk duhet të rrezikohet struktura.*** Nëse vihet re humbja e stabilitetit të strukturës (devijime të mëdha) atëherë Kontraktuesi do të marrë masa të menjëhershme për të siguruar punimet dhe të evakujë dhe të izolujë zonën dhe të informojë Mbikqyrësin.

1.8.2 Zbritja e Materialeve:

Kur materialet ose mbeturinat zbriten nga lartësitë, kujdes duhet të merret për të parandaluar levizjet e materialeve, rëni në mënyrë të tillë që ajo krijon një rrezik për sigurinë e personelit ose të pronës publike të çdo lloji.

1.8.3 Shërbimet ekzistuese:

Telatekzistuese elektrike dhe përcjellësqë mbetendo të shkëputen me kujdes nga instalimet/kapësete tyre (pa shkëputje), të ripozicionohen jashtë vendeve ku aktualisht punohet dhe të mbrohen nga dëmtimi. Paraprihjes së punimeve kontraktuesi do të kontrollojë përvendndodhjen e shërbimeve të padukshme.

1.8.4 Dëmtimet gjatë Dimrit:

E gjithë ndërtesa duhet të jetë e mbrojtur nga dëmtimet dimrit tilla si shpërthimet e tubave të ujit gjatë punimeve të prishjeve. Nuk duhet të punohet në temperatura më të ulët se 5°C.

1.8.5 Punimet e Çatave:

Gjatë punimeve të çatave Kontraktuesi do të sigurojë ndërtesën nga kushtet e motit në çdo kohë. Material për mbulim të përkohshëm të tilla si copa për mbrojtjen ndaj motit do të sigurohen si dhe kur të kërkohet. Në përgjithësi heqja e mbulimit duhet të bëhet në koordinim me fazat e punimeve të çatave në mënyrë që kërkesa e mbulimit të përkohshëm të jetë në minimum.

1.8.6 Mbrojtja e punës dhe e publikut

Sipërmarrësi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jetës publike rreth sheshit të ndërtimit. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndërtesave dhe të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të kqyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

Gjatë zbatimit të punimeve Sipërmarrësi duhet të vendosë dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Sipërmarrësi duhet të sigurojë pengesa të përshtatëshme, shenja me dritë të kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të përbëjnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

1.8.7 Mbajtja pastër e ambjentit përreth monumentit:

Rruga hyrëse në objekt dhe ambjenti përreth tij që përdoret aktualisht si varrezë, do të mbahen pastër çdo ditë. Kontraktuesi do të marrë masat e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e objekteve përreth dhe ambjentit duke siguruar hyrje / daljen e materialeve nga kantieri.

1.8.8 Mbrojtja e pemëve:

Të gjitha pemët të cilat nuk janë të aprovuara për prerjen duhet të mbrohen nga dëmtimi gjatë tërë periudhës së kontratës. Pemët me diametër më të madh se 10 cm dhe të larta deri 1m mbi tokë (shkurret, barërat etj) do të priten, pa lejen paraprake të autoriteteve dhe të mbikëqyrësit.

1.8.9 Mbrojtja e ambjentit

Sipërmarrësi duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundëshme për të siguruar që ambjenti lokal i ansamblit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera.

1.9 Shërbimet e jashtme:

Duhet të mbrohen të gjitha shërbimet elektrike dhe komunale. Kontraktuesi do të zbulojë të gjitha shërbimet nëntokësore në kantier para fillimit të punimeve të gërmimit. Lejet e gërmimit do të merren nga furnizuesit e shërbimeve dhe një kopje do të dorëzohet tek Mbikqyrësi. Kur heqja e shërbimeve ekzistuese dhe kalldrëmit është specifikuar apo të nënkuptuara, do të sigurohen barrikada të miratuara, mbulimin e përkohshëm në zonat e ekspozuara dhe lidhje të përkohëshme për sistemet elektrike dhe të shërbimeve komunale. Distanca e nevojshme e punës të sigurt nga lart për linjat e tensionit të lartë do të caktohet dhe të miratohet me kompaninë e shpërndarjes elektrike. Një kopje e kësaj leje do të lëshohet nga Mbikqyrësi. Kontraktuesi do të ketë kohë të mjaftueshme para fillimit të punimeve, të informojë autoritetet përkatëse në mënyrë që mund të ndërmerren hapat e nevojshëm për të bërë të mundur spostimin e kablllove.

1.10 Skeleria:

Të gjitha skelat duhet të projektohen dhe të montohen në përputhje me standardet e kërkuara. Vetëm punëtorët me përvojë dhe kompetent do të montojnë skelerinë në lartësi. Kontraktuesi do të sigurojë që çdo modifikim të nevojshëm të skelave gjatë rrjedhës së punëve, do të pranohen nga montuesit e skelave në mënyrë që skela do të mbetet i përshtatshëm për qëllimin për të cilin janë të dedikuara. Nënshkrimi i miratimit të skelës do të bëhen i dukshëm në çdo pikë të hyrjes në nivel të tokës tek skela. Punimet në skelë të paautorizuara është rreptësisht e ndaluar. Duhet patur kujdes që ngarkesa e cdo grumbulli mbeturinash në skelë nuk e duhet ta kalojë ngarkesën e lejuar sipas projektimit. Ngarkesat maksimale të lejueshme të skelave do të jenë qartë të dukshme në të gjitha pikat e hyrjes në nivelin e tokës. Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar hedhjen aksidentalisht të mbeturinave nga platforma. Skela metalike e tipit mbështetës, në përputhje me standardet dhe rregullat lokale, duke përfshirë furnizimin e mbështetëses, mirëmbajtjen, montim, ankorimit, çmontimin etj 15cm nga dyshemeja do të vendosen në të gjitha nivelet. Copë mbrojtëse ndaj motit ose të paktën rrjetë mbrojtëse duhet të vendoset në pjesën e jashtme të skelës.

1.11 Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Të gjitha materialet që sillen nga Kontraktori, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatshme për t'i mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyrësi i Punimeve në çdo kohë.

1.12 Pastrimi përfundimtar i zonës

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Kontraktori duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme.

SEKSIONI 2. PUNIME PRISHJEJE-ÇMONTIMI DHE PASTRIMI

2.1 Të përgjithshme

Punimet e prishjes dhe çmontimit në restaurim janë një proces i rëndësishëm, në të duhet të marrin pjesë punëtorë të specializuar të cilët duhet të mbikëqyren në çdo rast nga drejtuesi teknik i punimeve. Nëpërmjet prishjes evidentohen gjurmë të reja të cilat sjellin dëshmi të reja lidhur me monumentin të cilat duhet të dokumentohen. *Materialet e nxjerra nga çmontimi pas seleksionimit nëse nuk janë të dëmtuar ripërdoren.*

REFERENCAT: Publikimetë listuaramë poshtëformojnë njëpjesë tëkëtijspecificimi të referencave të zgjeruara.Botimet qëjanë të referuaranë tekstjanë të përcaktuara vetëm për gjërat bazë.

2.1.1 Ligjetdhe Normat e aplikuarashqiptare:

- Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me parimet e “Kartës Shqiptare të Restaurimit” , VKM. Nr.426, 13 Korrik 2007.

- Ligji Nr.9048, datë 04/07/2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, (I ndryshuar)

DORËZIMET : Dorëzimet në vijim:

2.1.2 *Deklarimet:*Dorëzimi i procedurave të propozuara të prishjevedheheqjes së materialevetek Mbikqyrësipër miratim, para sepunatë fillojë. Proçedurado të sigurojëheqjen ekujdesshmedhe sistemimin ematerialevenë koordinim meveprat e tjeranë proçes, dhe një orarpër mospengimin eshërbimeve komunale, të gjithalejeve të nevojshmengakompanitë e furnizimit e të shërbimeve. Njëpërsshkrim të detajuar tëmetodave dhepajisjeve që do tëpërdoren për çdopune dhetëvazhdimitsëpuneve që kryhen.

2.1.3 *Kushtet e mbikqyrjes:*Në rastet kur pronafqinjemund tëdëmtohetngapunimetatëherëKontraktuesi duhet tëkryejëme shpenzimet e tijnjë studimtë detajuar të gjendjes së pronësfaqinjepërfshirë këtu edhe dokumentacioninfotografiknjëkopjee të cilitduhet tëparaqitetdhe tëmiratuar ngaMbikqyrësi para fillimit tëpunimeve.

KËRKESAT: Puna përfshin çmontimin dhe largimin e të gjitha materialeve të diktuar ose të specifikuar. Punimet e prishjeve nuk do të fillojnë deri sa autorizimi të merret nga Mbikqyrësi. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishja, përveç nëse tregohet apo të specifikohet ndryshe, do të largohen nga kufijtë e sheshit të ndërtimit. Mbeturinat do të hiqen nga kantieri çdo ditë, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Mbikqyrësi; akumulimi i materialit të tillë është i ndaluar. Materialet të cilat nuk mund të hiqen brenda ditës do të ruhen në mënyrë të përshtatshme në zonat e përcaktuara. Nëse Kontraktuesi identifikon kalbësira në dru gjatë punimeve të çmontimit ai do të marrë masat e duhura për sigurinë e shëndetit. Njoftohet menjëherë Mbikqyrësi dhe i propozohen masa të përshtatshme për miratim. Kontraktuesi duhet të paraqesë prova për asgjësimin e duhur të materialeve me kërkesë të Mbiqyrësit.

2.2 Pastrimi i kantierit

2.2.1 Pastrimi i kantierit:

Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjitha pirgjet e mbeturinave të tjera.

2.2.2 Mbrojtja e objekteve, rrethimeve dhe strukturave:

Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojnë objektet dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse.

Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese të çdo lloji.

Duhet bërë kujdes nga kontakti me kabllot elektrik.

2.2.3 Mbrojtja e vendit të pastruar:

Kontraktori duhet të ngrejë rrjetë të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

2.3 Punime prishjeje

2.3.1 Skeleritë:

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Në rastet e kryerjes së punimeve në anë të rrugës ku ka kalim si të kalimtarëve, ashtu edhe të makinave, duhet të merren masa që të bëhet një rrethim i objektit, si dhe veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

Skeleri çeliku të tipit këmbalec, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, më lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

Skeleri çeliku në kornizë dhe e lidhur, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, me lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

2.3.2 Mbikqyrja

Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe të mbikëqyrë punën për ngritjen e skelave në kantier.

2.3.3 Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objekteve.

Metodat e prishjes së pjesshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë statike të objektit.

Kur prishja e elementeve të ndërtesës nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të stukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë.

Në përgjithësi, puna e çmontimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, *pa ndërhyrë në elementët bazë struktural*. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të ndahen dhe do të ulen në tokë nën kontroll.

2.4 PUNIME PRISHJE DHE PASTRIMI TË ELEMENTËVE TË OBJEKTIT

2.4.1 Çmontim çatie (rrasa guri)

Përpara fillimit të punimeve të restaurimit të çatisë, kryhen punimet e çmontimit të elementëve të mbulesës. Për zbulimin e saj duhet të punohet me skeleri, në mënyrë të tillë që elementët që hiqen si nga çatia dhe rrasat të mos dëmtohen. Punimet duhet të kryhen me kujdes, për të zbuluar ndonjë element apo gjurmë të fazave më të hershme. Për çfarëdollojë gjetje të re të tillë, e cila nuk është e identifikuar në vizatime dhe përshkrime të njoftohen specialistët e IMK dhe projektuesit.

Pra në çmimin e këtij zëri punimi, përfshihen tërësia e punimeve që duhet për zbulimin, uljen në tokë , stivosjen dhe pastrimin e materialit të dalë nga prishja e kësaj çatie ekzistuese , si dhe pastrimin e murit të sipërm të ndërtesës nga të gjitha mbeturinat e çatisë, e cila përfshinë në detaje:

Heqjen me kujdes të rrasave të gurit dhe seleksionimi i rrasave të pa dëmtuara, të cilat do të depozitohen dhe zbriten me kujdes në tokë nëpërmjet ulluqeve të krijuar, dhe rradhiten , për t'u ripërdorur, duke i sistemuar sipas grupimeve në terren. Rrasat e gurit në gjendje të mirë dhe dimension të përshtatshëm, që do të ripërdoren, duhet të lëshohen dhe pastrohen me furçë të ashpër në mënyrë që nga sipërfaqja e tyre të largohen të gjitha llojet e myshqeve dhe papastërtitë e tjera, duke krijuar një sipërfaqe perfekte të tyre.

Heqja e lëndës drusore, kryhet në objekt, ku nga gjendja e verifikuar ajo është e papërshtatshme për tu ripërdorur, në këto kushte ajo do të sistemohet dhe stivohet në një vend të përcaktuar nga Mbikëqyrësi i punimeve, dhe do të jetë në ruajtje nga sipërmarësi i punimeve, duke e inventarizuar dhe dorëzuar bashkë me objektin. Lënda drusore do jetë e pastruar nga gozhdët dhe hekurat lidhës dhe duhet stivohet në mënyrë të tillë, që të ajroset dhe të mos mbajë lagështirë.

Heqja dhe çmontimi i shtresës së petavrave të drurit (dërrasave të shtruara nëçati) e cila duket shumë e dëmtuar. Këto pastrohen nga gozhdët dhe mbeturinat dhe stivohen me dërrasat e tjera sipas përshkrimit të mësipërm.

Mbasi bëhen këto punime paraprake, në prezencë të kontraktorit, dhe mbikëqyrësit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë që do të përdoret brenda kushteve teknike dhe për pjesën e dëmtuar që do të hidhet.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m² çati në plan .

2.4.2 Pastrim Ambjenti nënçati

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin nga papastërtitë dhe pluhurat që ndodhen në ambjentin nënçati. Para pastrimit verifikohet gjendja jashtë funksionit e elektricitetit në instalimet elektrike që mund të ndodhen aty dhe në bazë të verifikimit për gjendjen teknike të tyre merret vendim për çmontimin dhe largimin e mundshëm të tyre.

Nëçmimin e pastrimit të ambjentit nënçati se çatisë, përveç punimeve të mësipërme përfshihet dhe pastrimi i mureve, në sipërfaqen mbështetëse të tyre (pjesën ku ka qenë e mbështetur çatia) me kujdes duke larguar gurët që lëvizin dhe duke i shënuar me numër ata për t'i rivendosur aty ku janë , si dhe bëhet fshirja me fshesë dhe ujë i gjithë mbeturinave që janë mbi muret

ekzistuese, si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë fund heqjes dhe pastrimit të murëve që kanë mbajtur çatinë

Ky çmim është për njësi Lekë / m³

2.4.3 Çmontim i muraturës prej guri

Në fillim do të bëhet seleksionimi i atyre gurëve që ndodhen brenda ambjentit të narteksit të rrënuar në mënyrë përdorim të tyre për integrimin e muraturës së narteksit. Vënie mënjane dhe pastrimin e tyre për ripërdorim, duke bërë sistemimin brenda ambientit të kantierit. Më pas vazhdohet me çmontimin e muraturës gjysëm të rrëzuar me mur guri po këtu në pjesën e narteksit aty ku ka nevojë, që ka deformim të muraturës apo humbje të fugatimit. Kjo do të bëhet në mënyrë manuale duke çmontuar dhe rindërtuar muraturën me gurët sipas rradhës që kishin. Pasi të kemi konsoliduar mirë këtë muraturë perimetrale do të vazhdojmë me ngritjen më tej të saj duke përdorur gurët origjinal që hoqëm mënjane nga grumbulli i rrënojave.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

2.4.4 Skelë me tubo fasade ~ 8m

Ndërtimi i një skele për kryerjen e punimeve në mure dhe në prishjen e çatisë me tubo metalike e cila duhet të krijoj siguri gjatë gjithë punimeve.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.4.5 Pastrim nga bimësia e ulët+injektimi solucionit për tharjen e bimëve të këqija - (R. 5/1)

Ky zë përfshin gjithë pastrimin nga bimësia e ulët në muraturë si dhe ambjentin përreth kishës.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.4.6 Prerje dhe tharje të rrënjëve masive(raundap 200cc)

Prerje të rrënjëve të pemëve të cilat ndodhen në muret e ndërtesës dhe brenda territorit të saj, si dhe spërkatjen me herbicide për përtharjen e rrënjëve të pemëve.

Ky çmim është për njësi Lekë/ cope.

2.4.7 Pastrim nga shtresa e suvasë (llaç gëlqere në brendësi të muraturës)

Në momentin e sistemimit të territorit të jashtëm, pasi zgjidhim dhe problemin e lagështirës nga jashtë do të lëmë përtharjen e lagështirës në muraturë dhe aty ku konstatojmë duke dëgjuar tingullin e saj me anë të trokitjes, që suvaja jo e pikturuar është tepër e shkëputur do të bëjmë prishjen me kujdes të saj me mjete jo të forta me qëllim mos dëmtimin e suvasë të padëmtuar. Nënçmim do të përfshihet dhe kruajtja dhe pastrimi me furçë të sipërfaqes ku ka rënë suvaja.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

2.4.8 Pastrim fugash në muraturë guri (llaç çimento)

Pastrimi i fugave do të fillojë me pastrimin mekanik të fugave nga llaçi degraduar apo i punuar pa kujdes dhe me material të papërshtatshëm. Pas pastrimit mekanik, duhet të bëhet larja e tyre me ujë të bollshëm. Rifugatimi do të kryhet me llaç gëlqere të majmë.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin dhe heqjen e kujdesshme të shtresës së llaçit në fugat e portës hyrëse për në hajat dhe në muraturën e jashtme të naosit me furçë teli të ashpër .

Ky çmim është për Lekë/ m².

2.4.9 Pastrim fugash jo të rregullta dhe në vendet me çarje në muraturë guri (llaç gëlqere) -

Pastrimi i fugave do të fillojë me pastrimin mekanik të fugave nga llaçi degraduar apo i punuar pa kujdes dhe me material të papërshtatshëm. Pas pastrimit mekanik, duhet të bëhet larja e tyre me ujë të bollshëm. Rifugatimi do të kryhet me llaç gëlqere të majmë.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin dhe heqjen e kujdesëshme të shtresës së llaçit në fugat e xokolit me furçë teli të ashpër.

Ky çmim është për Lekë/ m².

2.4.10 Heqje dyer, dritare ,

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve të çmontimit të elementeve prej druri të dritareve të drurit të dëmtuara në naos, sëbashku me kangjellat të inkastruara në kasat e drurit të dritareve, gjithashtu çmontimin e portës hyrëse për naos, dhe çmontimin elementit të karrikes sëbashku me dyshtet prej druri ku ajo mbështetet. Vendimi për çmontim merret pas verifikimit të dëmtimit të tyre, e rëndësishme është kontrolli i gjendjes së tyre strukturale, të shkallës së amortizimit të lëndës drusore nga mbikqyrësi i punimeve të restaurimit. Elementët në gjendje të mirë që konsiderohen origjinalë apo që mbartin vlera duhet të ruhen dhe të konsolidohen. Realizohet para

punimeve të tjera si ato të restaurimit të murit apo suvasë. Ato përfshijnë heqjen e kujdesshme të telajove si dhe sistemimin e tyre në një vend të caktuar brenda ambientit të kantierit për ripërdorim të materialit të padëmtuar. Elementët origjinalë të dëmtuar plotësisht, do të ruhen për t'u referuar për dimensione dhe tip dritareje, porte dhe karrikeje për të rindërtuar këto elemente me të njëjtën formë dhe dimension si ato. (shiko detajet në fletët grafike)

Në restaurimin e dyer / dritareve do të përdoret dru pishe i stazhionuar.

Ky çmim është për njësi Lekë/m².

2.4.12 Transport mbeturinash deri në 10 km

Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga komuna deri në 10 km larg nga kantieri.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³

2.4.13 Gërmim dhe transport dherash

Ky çmim parashikon gërmimin e dherave të grumbulluar në vite si pasojë e mosmirëmbajtjes së objektit. Uljen e kuotës së tokës në nivelin 0.0 m në pjesën e hajatit, si dhe uljen e kuotës së tokës në nivel -0,20 m në të gjithë perimetrin e kishës për të eliminuar kështu gjithë lagështirën në brendësi të muraturës. Po kështu dhe uljen dhe nivelimin disi të terrenit në pjesën e sipërme të skarpatës, përgjatë murit mbajtës perimetral me qëllim mos zbarkimin e dherave në vite që mund të bllokojnë kuletën perimetrale.

Dherat e tepërta grumbullohen për t'u hedhur, në vendet e përcaktuara nga komuna.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

SEKSIONI 3. NDËRHYRJE KONSERVUESE DHE RESTAURUESE

3.1 Të përgjithshme

Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me Projektin e miratuar në KKR si dhe parimet e “Kartës Shqiptare të Restaurimit” – VKM Nr.426 on 13 Korrik 2007.

3.2 Shpjegim i terminologjisë

“Konservim” janë të gjitha masat e ndërmarra që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në vepër siç janë krijimi i kushteve mjedisore (lagështi relative, temperaturë, pastërti nga ndotja atmosferike, mbrojtja nga pluhurat, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), si edhe ndërhyrjet kimike direkt në objekt apo vepër, me qëllim parandalimin e çdo lloj dëmtimi.

“Ndërhyrje” është tërësia e masave të ndërmarra dhe operacioneve të kryera në vepër, me qëllim ndalimin e degradimit të mëtejshëm dhe nxjerrjen në pah të vlerave të saj.

“Restaurimi” është vlerësimi i thelbit origjinal të monumentit nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme dhe nxjerrjen në pah të vlerave të tyre.

Këshillat mbi Parimet dhe Metodatat të cilat ofrojnë udhëzimet e propozuara të ndërhyrjeve restauruese duhet të lexohen së bashku me këtë dokument.

3.3 Ndërhyrjet në “monumentet e kulturës”

Në disa raste nevojat për konservim duhet ti paraprijnë atyre të vendosjes në siguri, në vazhdim nuk është e nevojshme të rregullohen nivelet e sigurisë të një ndërtese historike me ato ndërtesave të reja por është e mjaftueshme që nivelet e sigurisë të përmirësohen krahasuar me ato para ndërhyrjes.

Teknikat e ndërhyrjeve që do përdoren në monumentet e kulturës duhet të respektojnë karakteristikat historike, artistike, arkitektonike dhe shpërndarjen e tyre. Kjo do të thotë që përmirësimi duhet të realizohet pa prodhuar modifikime substanciale në sjelljen e strukturës dhe ndërtesës duke përdorur për sa është e mundur teknika ndërhyrje dhe metodologji operative tradicionale, konservim të materies, kushteve fizike dhe morfologjike. Teknika dhe materiale me karakter reversibël edhe pjesor që përdoren në mënyrë diskrete, jo evazive dhe në koherencë me llogjikën konstruktive të strukturës ekzistuese.

3.4 SPECIFIKIMET E NDËRHYRJEVE RESTAURUESE

3.4 aPUNIME MURATURE

3.4.1 Mur guri në lartësi deri 3m me llaç gëlqere 1:3 (narteks dhe hajat)

Kyçmim përfshin gjithë ngritjen e murit perimetral të narteksit, ngritjen e murit që ndan ambjentin e naosit nga ai i narteksit me një portë me hark, si dhe ngritjen e muraturës në të dy krahët e hajatit, gjithashtu plotësimin e muraturës së parapetit të hajatit. I gjithëky proces do të bëhet pasi të kemi konsoliduar të gjithë muraturën ekzistuese të rrënuar, aty ku shohim që ka deformime si dhe shkeputje të materialit. Pasi të kemi konsoliduar murin ekzistues do të vazhdojmë ngritjen e muraturës duke përdorur si edhe thamë gurët të marrë nga rrenojat të cilët fillimisht i kemi pastruar, si edhe plotësimin e muraturës me gurë të marrë nga burime të afërta, i cili do jetë disi më i punuar në krahasim me ekzistuesin, për t'u dalluar nga ai dhe për të përcaktuar kohën e ndërtimit të tij, gjithashtu realizimin e një fuge ndarjeje vizive që ndan pjesën e murit të poshtëm ekzistues nga muri i ri. Muri i ri do të punohet me llaçgëlqere 1:3.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³

3.4.2 Ndërtimi i kupolës së re, dhe qemerëve mbajtës të saj

Ky zë përfshin tërësinë e punimeve:

- ndërtimi i një skele druri në vendin ku do të ndërtohet kupola.

Ndërtimi i një kallëpi druri, të përforcuar mirë dhe të mbështetur mbi skeleri, sipas formës së kapriatës së përcaktuar në projekt.

Pas ndërtimit të kallëpit të kupolës, bëhet lyerje me vaj e kallëpit, në mënyrë që të mos ngjiten llaçrat në të. Pastaj fillon ndërtimi i kupolës prej guri, ku trashësia e gurit nuk duhet të jetë më i vogël (kjo në trashësi) se 30 cm. Çdo gurë do jetë punuar e gdhendur, në formën e një pyke pa majë, duke siguruar kështu ndërtimin e një kapriate të qëndrueshme. Punohet me rreshta horizontal deri sa rrethi mbyllet, duke u shtrënguar vazhdimisht mbi kallëp dhe gurët me njëri tjetrin, dhe në fund vendoset kyçi i kupolës, i cili siguron qëndrueshmërinë e kupolës.

Pasi kanë përfunduar punimet e saj, hiqet skeleria, pastrohen llaçrat e tepërta dhe sipërfaqja e brendshme e kupolës, bëhet gati për suvatim, pa prishur tërësisht skelën mbajtëse.

Llaçi që përdoret në këtë kupol do të jetë Llaç bastard marka 30.

Në çmim përfshihet çdo punë që lidhet me përfundimin e këtij procesi.

Ky çmim është për Lekë/ m² sipërfaqe së brendshme të kupolës.

3.4.5 Konsolidim i kreut të murit me 2cm llaç gëlqere 1:3

Ky çmim përfshin konsolidimin e kreut të murit me 2 cm llaç gëlqeretë murit perimetral, në mënyrë nivelimin e sipërfaqes së sipërme të muraturës ku dotë vendoset dhe trau perimetral, mbi të cilin do tëmbështeten kapriatat e çatisë.

Ky çmim është për Lekë/ m²

3.4.6 Restaurim i çarjeve në kupolë dhe qemere sipas procedurës

Ky zë përfshin restaurimin e çarjeve të shumta në kupola si dhe qemere, ku sipërfaqja e tyre është me piktura murale. Në këtë pjesë do të bëjmë një ndërhyrje të kujdesshme në mënyrë mos dëmtimin dhe mos shkëputjen e pikturave nga sipërfaqja e muraturës. Prandaj do të veprohet në këtë mënyrë:

Pasi të kemi veshur pjesën e sipërfaqeve të pikturuara pranë sipërfaqeve tëçara me letër japoneze në mënyrë që gjatë punimeve të mos kemi shkëputje të tyre, do të vazhdojmë me vendosjen e pykave të drurit ose të gurit në thellësi tëçarjeve në mënyrë shtrëngimin e sipërfaqes se çarë si dhe më pas do të vazhdojmë me fugatimin në brendësi të tyre me llaçbastard marka 30. Me pas këto tëçara do të suvatohen me llaç gëlqere.

Ne rastet kur kemi çarje sipërfaqësore do të bëjmë thjesht fugatimin me llaç gëlqere hidraulike.

Persa i përket pjesës ku kemi mungesë të materialit të qemerit dhe mungesë të pikturës murale veprohet:

Çmontimi i qemerëve do të dallojë në raport nga tipologjia dhe aparati i muraturës së qemerit, nga natyra e uljes dhe paqëndrueshmërisë së strukturës. Pas provave për të marë informacionin e duhur dhe pas vendosjes së qemerit në siguri nëpërmjet puntelave dhe strukturave provizore (duhet bërë kujdes në balancimin e shtytjes që vjen nga qemeri) vazhdohet me çmontimin e qemerit nga qendra në krahët. Do të zbërthehen vetëm pjesët shumë të dëmtuara si pjesë e procesit të konsolidimit si dhe plotesimi i strukture se qemerit/ harkut te gurit (zgavrat ku mungon materiali).

Pastrimi do të vazhdojë me furça teli, kompresor ajri apo sisteme të tjerë që Mbikqyrësi i shikon të arsyeshme.

Ky proces do të kryhet në prezencë të mbikqyrësit të punimeve restauruese, si një proces tepër delikat, ku do të gjykohet dhe trajtimi pjesë pjesë i qemerit nëpërmjet konsolidimit të materialit ekzistues me materialit të gurit nëse shikohet e domosdoshme.

Do të verifikohen paraprakisht karakteristikat fizike e mekanike të harkut llaç gëlqere hidraulike, fugatimit dhe zbërthimit e zëvendësimit të elementëve të gurit (materiali, spesori, mënyra e lidhjes së elementëve). Do të analizohet shkalla e degradimit të strukturës.

Ky çmim është për Lekë/ m² sipërfaqe murature.

3.4.7 Restaurim i çarjeve në mur guri me teknikën e injektimit (Pastrim i çarjes, larje ne ujë, injektim llaç gëlqere 1:3)

Fugatimet sipërfaqësore kryhennë ato raste, kur çarjet janë të një madhësie mesatare dhe llaçi ekzistues është i degraduar.

Përbërja e llaçit do të përcaktohet në bazë të karakteristikave të llaçit ekzistues.

Në çmim përfshihet i gjithë procesi i pastrimit të llaçit ekzistues të dëmtuar në masën deri 3 cm dhe vendosja e llaçit të ri i cili ngjishet mirë. Mbasi fillon prezën llaçi, atëherë ai laget dhe fërkohet me furçë teli për të eliminuar plasaritjet eventuale të tij. Do të realizohen disa mostra fugash për të gjykuar për ngjyrën dhe përbërjen e llaçit dhe do të merret vendim nga supervizori i punimeve.

Në çmim përfshihet çdo punë që lidhet me përfundimin e këtij procesi.

Ky çmim është për Lekë/ m².

3.4.8 Fugatim mur guri i naosit dhe portës hyrëse të kishës

Në punimet e konservimit të muraturave në pjesën më të madhe i takojnë punimeve të fugatimit. Është e rëndësishme të bëhen analiza të miratuara, për të mësuar përbërjen kimiko-fizike të llaçit në mënyrë që të përcaktosh qartësisht natyrën, prejardhjen dhe granulometrinë e materialit të përdorur. Përbërja e llaçit duhet të jetë me material analog të atij ekzistues.

Fugatimet do të kryhennë ato raste kur muratura e gurit do të zhvishet nga suvatimet dhe shtresat e gëlqeres të shtuara në kohë apo kur llaçi i fugës është i degraduar. Fugatimi do të fillojë me pastrimin mekanik (gërryerjen) të fugave nga llaçi degraduar apo nga llaçi me çimento.

Pas pastrimit mekanik të fugës dhe larjes me ujë të bollshëm do të kryhet mbyllja e fugave. Masa e llaçit të përgatitur, duhet të jetë homogjen dhe uniform. Fugatimi do të kryhet me llaç gëlqere të majmë, me konsistencë të ulët.

Mbasi fillon prezën llaçi, atëherë ai laget dhe fërkohet me furçë teli për të eliminuar plasaritjet eventuale të tij.

Në çmim përfshihet, transporti i materialeve dhe gjithçka duhet për përfundimin e këtij procesi.

Ky çmim është për Lekë/ m².

3.4 b PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATIE

3.4.9 Mbulim çatie rrasa guri

Çatia e ambjentit të kishës që përfshin naosin dhe narteksin është menduar të realizohet me konstruksion kapriata dru pishe të stazhionuar me solucion antimol dhe vaj lini dhe insekticid, pasi nuk dihet saktësisht sistemi i çatise aktuale (do të shihet gjatëçmontimit në objekt). Në pjesën sipër kupolave kapriatat do të jenë të hapura, ndërsa në pjesën sipër narteksit ku nuk do të kemi ngritje të kupolave kapriatat do të jenë të mbyllura. E gjithë kjo pjesë e çatisë që mbulon naosin dhe narteksin do të realizohet si një skemë më vete, ndërsa pjesa që përket pjesës së hajatit çatia do të realizohet me binarë druri të pjerrët të mbështetur në murin mbajtës perimetral dhe që përfundojnë në kolona të rrumbullakta druri me seksion 20 cm, duke iu referuar elementëve të paraqitur në fotot e arkivës, treguar sipas skemës së paraqitur në vizatime. Streha e çatisë del rreth 20 cm jashtë muraturës. Duke ju referuar vizatimeve të projektit të çatisë, kapriatat do të jenë të inkastruara në mure nëpërmjet foleve prej betoni dhe hekurave fi. 4 mm, të paratensionuar që lidhin kapriatën me murin.

Materiali i drurit në kapriata, do të jetë dërrasëpishe e sharruar me dimensione (5x20)cm që do të jetë lëndë e stazhionuar dhe e impenjuar në vaj lini dhe insekticid. Prezenca e lagështirës nuk duhet të jetë më shumë se 10%.

Gozhdimi i kapriatave dhe përforcimi i tyre bëhet duke i përdorur ato në kah të kundërt, të kryqëzuara dhe duke përthyer gozhdët në daljet e majave të tyre.

Po kështu, edhe lënda e rrumbullakët që do të përdoret në hajat, do të jetë e inkastruar në mure, nën kuotën e fundit të çatisë, duke hapur fole në vendosjen e çdo lënde. Edhe lënda e rrumbullakët duhet të jetë e pastruar nga lekurat dhe mundësisht të jetë sipërfaqe e pastër dhe pa nyje, në mënyrë që të mos pësojnë këputje. Edhe lënda e rrumbullakët duhet të jetë gjithashtu stazhionuar, e impenjuar në vaj lini dhe insekticid dhe me prezencë të lagështirës deri në 10%.

E gjithë sipërfaqja e çatisë dhe e hajatit, do të jetë e shtruar me dysHEME dërrase (petavra) $t = 2.5 * 15 \div 20$ cm (dru pishe i stazhionuar). Petavrat (lënda e drurit) do të jenë pishe të stazhionuara dhe të impenjuara me solucion antimol, anti lagështirë, insekticid dhe me vaj lini. Petavrat do të vendosen 1-2 cm larg nga njëra-tjetra për të siguruar ajrosjen e çatisë duke u gozhdur me gozhdë 4 cm.

Mbi dërrasa në formë të rregullt shtrohen rreshtat e rrasave të gurit, të cilat shërbejnë si mbulesë përfundimtare për çatinë, të cilat në kulmet e tyre kapen me llaç-gëlqere, për të mos lejuar shkarjen e tyre. Rrasat e reja dhe ato ekzistuese, duhet të jenë të pastra nga materialet bimore dhe myshqet e ndryshme.

Lënda e drurit e cila do të përdoret do të jetë dru pishe e stazhionuar mirë dhe e cilësisë së lartë, me karakteristika:

- ❖ Lagështi jo më tepër se 10 %,
- ❖ Peshë volumore 410 – 540 Kg/m³,
- ❖ Kufiri i rezistencës në tërheqje 130 MPa,

Të gjitha materialet që do të përdoren do të jenë të pajisura me certifikatë cilësie përveç rrasave nëse janë të ripërdorura.

Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme, transporti i tyre, ngarkim shkarkimi, skleria dhe çdo punë që lidhet me të.

Kjo jepet për njësi Lekë/m² çati të përfunduar në plan.

3.4.10 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama

Ky çmim përfshin hidroizolimin e gjithë sipërfaqes së nënçatisë me 1 shtresë katrama 4 mm trashësi, e cila do të shtrohet mbi petavrat duke u preçinuar mbi to, dhe në vendet ku kryhet ky proces lyhet me bitum në mënyrë mos futjen e lagështirës në këto pika. Gjithashtu meqënëse këndi i çatisë është disi i pjerrët, shtresën e katramasë do ta granilojmë nga sipër duke vendosur mbi shtresën e katramasë ristela druri horizontale rreth 40 cm larg njëra tjetrës të cilat shërbejnë si barrierë për pengimin e rrëshqitjes së rrasave të gurit.

Kjo jepet për njësi Lekë/m².

3.4 C PUNIME SHITESASH

3.4.11 Restaurim i shtresave me pllaka guri

Proçesi i restaurimit të shtresave me pllaka guri, do të aplikohet në rastet kur pllakat e dyshemesë paraqesin disnivele, apo çarje të formatit të tyre. Në raste të tilla, do të ndërhyhet me heqjen e pllakave, nivelimin dhe ngjeshjen me tokmak të sipërfaqes së truallit ku qendrojnë dhe më tej, rivendosjen e tyre direkt në truall pa shtesë lidhëse, në përputhje me sipërfaqen. Për pllakat e çara, të shihet mundësia e riparimit me anë të pastrimit dhe përputhjes së buzëve bashkuese si dhe ngjitjes, kur është e mundur. Zëvendësimi dhe plotësimi i pjesëve ku ka mungesë të materialit guror të bëhet me material të njëjtë me atë ekzistues (vetëm në rast kur mungon totalisht).

Në çmim përfshihet, gjithçka duhet për përfundimin e këtij proçesi.

Ky çmim është për lekë / m².

3.4.15 Shtrim dysheme druri (hapësira e karrikeve)

Çmimi përfshin shtrimin me dysheme dërrase të hapësirave ku vendosen karriket (hapësira përgjatë mureve veriorë dhe jugorë të naosit). Për realizimin e dyshemesë do t'i referohet detajeve grafike. Do të përdoret dru pishe e stazhionuar. Dërrasat për realizimin e dyshemesë do të kenë përmasat e dyshemesë ekzistuese cm me gjatësi të ndryshueshme për zgjatimin cilat duhet t'i referohet binarëve të nënstrukturës mbi të cilat mbështetet dyshemeja. Elementët e drurit do të trajtohen me antimol dhe dy duar vaj lini.

Në çmim përfshihet, gjithçka duhet për përfundimin e këtij procesi.

Ky çmim është për lekë / m².

3.5 PUNIME DYER, DRITARE,

3.7.1 F.V. dyer dhe dritare - (R.98; R.101)

Dyert dhe dritaret janë pjesë e rëndësishme arkitektonike dhe funksionale e ndërtesës. Ato sigurojnë ndriçimin për pjesët e sipërfaqes së brendshme të tyre. Madhësia (dimensionet) e tyre duhet të jetë sipas modelit origjinal. Dyert dhe dritaret do të prodhohen prej druri pishe, të stazhionuar, dhe imprenjuar dhe do të lyhen me vaj lini dy duar.

Pjesët kryesore të dritareve janë: Kasa e dritares që fiksohet në mur me elemente prej hekuri përpara suvatimit. Korniza e dritares do të vidhoset me kasën e saj mbas suvatimit dhe bojatisjes. Në bazë të formës dhe përmasave të dritareve ekzistuese, korniza do të pajiset në kasë me mentesha dhe bllokues të tipeve të ndryshme të instaluar në të. Kanatë me xhama të pahapshme, të pajisur me doreza të fiksuara dhe me ngjitës transparent silikon, si dhe me kanata fikse.

Kujdes duhet treguar me përputhjen e kasave me hapësirat përkatëse si dhe të jenë të plotësuara me aksesore.

Vendosja e dyerve në vepër duhet të bëhet sipas kushteve teknike për montimin e tyre të dhëna në standartet shtetërore. Mënyra e vendosjes së tyre është në varësi të llojit të derës dhe materialit që përdoret për prodhimin e tyre. Për modelin e dyerve do t'i referohet modelit origjinal dhe konsultave në vend me supervizorin.

Kampione të artikujve të propozuar, do ti paraqiten paraprakisht mbikqyrësit të punimeve për aprovim paraprak.

Druri i pishës do të ketë këto karakteristika.

- Lagështi jo më tepër se 7-8 %,
- Peshë volumore 410-540kg/m³,
- Kufiri i rezistencës në tërheqje 130 MPa,

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve të sipërpërmendura, materialin drusor të përpunuar nga specialistët si dhe aksesoret, furnizimin dhe vendosjen në vepër, transportin dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

Ky çmim është për lekë/ m².

Përgatiti Relacionin:

Ark. Arbiona Bala

Ark. Fotjon Qirinxhi

Ing. Xhuljana Avdolli

Amanda
Cici

Digitally signed by
Amanda Cici
Date: 2023.06.12
16:02:25 +02'00'

Fotjon
Qirinxhi

Digitally signed by
Fotjon Qirinxhi
Date: 2023.06.12
20:03:43 +02'00'

